



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

KONTRATA

Numri i kontratës: 101-24-1364-1-3-6/C129

Kuvendi i Republikës së Kosovës (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në një të anë;
dhe

Dardaniya Group, SHPK, Pejë (Telefoni: +383 44 232 638; NUI: 811496290; E-mail: drilonsylaj76@gmail.com;) (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Furnizimi dhe montimi i ulluqeve në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës
Me numër prokurimi: 101-24-1364-1-3-6 (KU101 24 011 136)

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë:

Furnizimi dhe montimi i ulluqeve në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës

1.2 Kontrata hyn në fuqi me **02.04.2024** dhe përfundon me **16.04.2024**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **14 ditë** ditë nga data e hyrjes në fuqi të kontratës

1.4 Vendi i i furnizimit dhe montimit materailit sipas specifikimit teknik do të jetë Kuvendi i Republikës së Kosovës

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **1,955.00 €** (*Me fjalë: njëmijë e nëntëqind e pesëdhjetepesë euro*)

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale te pagesës pas pranimit të tërë dërgesës.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i **furnizimeve dhe i montimit** duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të **montimeve**.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij ***nuk arrin të bëjë furnizimin dhe montimin e materialit të kërkuar nga AK brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë***, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me

0,25% në ditë të vlerës së *furnizimeve dhe montimeve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit (prokurimit), dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën **shqipe** në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Shënim:

Kontratës i bashkëngjitet kopja e ofertës financiare e operatorit ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS		Për Operatorin Ekonomik Dardanija Group, SHPK	
Emri dhe mbiemri	Xhemail Halili	Emri dhe mbiemri	DRITON SYLA
Pozita:	Drejtor i Drejtorisë për Prokurim	Pozita:	MENAGTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	02.04.2024	Data:	02-04-2024
Vula:		Vula:	





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Titulli i kontratës: Furnizimi dhe montimi i ulluqeve në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës Numri i prokurimit: 101-24-1364-1-3-6 dhe numër të brendshëm: KU101 24 011 136

I. ÇMONTIMI I PJESËS SË PARË TË KULMIT NË KRAHUN S					
Poz.1	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Totali
1.1	Çmontimi i llamarinës dhe i rrufepritësit në parapedin e kulmit.	m ²	40.00	2.00	80.00
1.2	Çmontimi i llamarinës të kulmit në njerin krah	m ²	130.00	2.00	260.00
1.3	Demolimi i kanalit të ulluqeve ,furnizimi dhe montimi i te rejave.dim. e kanalit të ollukut :(45 x 25 x (25+35)cm. me kthesë	m'	48.00	20.00	960.00
1.4	Kthimi në vend dhe montimi i llamarinës dhe i rrufepritësit në parapedin e kulmit	m ²	40.00	1.00	40.00
1.5	Kthimi në vend dhe montimi i llamarinës të kulmit	m ²	130.00	1.00	130.00
1.6	Riparimi i krahut tjetër të ullukut	m'	50.00	3.00	150.00
1.7	Furnizimi me shrafa të reja të kulmit për llamarinë/dru (pako duhet ti ketë 100 copë)	pako	5.00	10.00	50.00
1.8	Furnizimi me silikon për llarinë	copë	15.00	5.00	75.00
Gjithsejt I :					1,745.00
II. ÇMONTIMI I PJESËS SË PARË TË KULMIT TË SALLA PLENARE					
Poz.2	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Totali
2.1	Çmontimi i llamarinës të kulmit të Salla Plenare	m ²	30.00	1.00	30.00
2.2	Furnizimi dhe montimi i të rejave në kulmin e Sallës Plenare	m'	15.00	10.00	150.00
2.3	Kthimi në vend dhe montimi i llamarinës të kulmit	m ²	30.00	1.00	30.00
Total - II :					210.00
Totali - (I + II) :					1,955.00

Shënim : Te gjitha matjet duhet te behen ne vendpunishte.

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	DARDANIJA GROUP SH.P.K
ADRESA E PLOTË	Rr.Bill Klinton pn. PEJE
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI	Drilon Sylaj
POZITA	Drejtor
NËNSHKRIMI	
DATA	04.03.2024
VULA	

